

Nr. 2604/007 K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 17/04/2026

Drejtuar: Anëtarëve të Komisionit të Posaçëm
Parlamentar për Realizimin e Reformës
Zgjedhore

Lënda: **REKOMANDIME** Lidhur me projektligjin
“Për financimin e partive politike”

Të nderuar Anëtarë të Komisionit!

Në përgjigje të kërkesës suaj, paraqiten më poshtë rekomandimet e KRIIK lidhur me projektligjin "Për financimin e partive politike".

Në parantezë, KRIIK sjell në vëmendjen tuaj se ky ligj nevojitet të jetë sa vizionar aq edhe efikas në parashikimet e tij, **nisur nga konteksti dhe sfidat** me të cilat vendi ynë përballet si politizimi i tejskajshëm, ligjzbatim i ulët, prania e informalitetit të lartë, korrupsionit madhor, prezenca e krimit të organizuar dhe e sasisë së madhe të parasë cash në qarkullim, përkundër institucioneve ende në forcim dhe një media e shoqërie civile të dobët.

Nisur nga përvoja e deritanishme me një ligjzbatim të dobët dhe pasiv, ky projektligj nevojitet **të përcaktojë specifikisht detyrime dhe detyra të qarta** në parashikimet e tij ndaj aktorëve të ndryshëm, në fushën e përgjegjësive individuale, të ndërveprimit institucional, me kopetenca dhe afate të qarta, sikurse edhe të përpiqet të përcaktojë sa të jetë e mundur **konceptet dhe kuptimin e qartë të termave që përdoren, pa lënë vend për discrecion apo interpretime të ndryshme.**

Në tërësi, në vlerësimin e KRIIK, projektligji përmban disa risi që meritojnë të evidentohen pozitivisht. Ndër to përfshihen përpjekja për të qartësuar terminologjinë dhe strukturën rregullatore të ligjit, zgjerimi i kufizimeve mbi burimet e financimit, vendosja e kufijve të përcaktuar për donacionet, forcimi i disa detyrimeve të transparencës dhe kontrollit të brendshëm, si dhe parashikimi i instrumenteve të reja për publikimin dhe monitorimin financiar. Vlen të evidentohet gjithashtu si element pozitiv fakti që kostot e auditimit parashikohen të mbulohen nga KQZ-ja dhe jo nga vetë nga partitë politike.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Megjithatë, projektligji mbart tri dobësi strukturore të cilat, në vlerësimin e KRIIK, kërkojnë rishikim thelbësor: (1) fragmentimi i kuadrit ligjor midis dy akteve normative, (2) dobësia e rolit kontrollues të KQZ-së dhe (3) mosadresimi i shpenzimeve nga palë të treta.

Nga ana tjetër, në perspektivën e KRIIK, në mënyrë që ligji të jetë në linjë me standardet më të mira të transparencës në një shoqëri që aspiron të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian në të ardhmen e afërt, do të duhet të adresohet qartë edhe (4) detyrimi për publikimin e të dhënave financiare të partive politike në format të hapur.

Gjithashtu, në gjykimin e KRIIK nevojiten të merren në konsideratë (5) përfshirja dhe adresimi i disa elementëve shtesë, të nevojshëm në funksion jo vetëm të transparencës së plotë ndaj aktivitetit financiar të partive, por edhe në funksion të forcimit të integritetit të tyre, standardit të demokracisë që aplikojnë, si dhe të ofertës elektorale që i ofrojnë vendit e shoqërisë.

Rekomandimet lidhur me këto pesë problematika paraqiten në Seksionin I. Seksioni II paraqet rekomandime më specifike, dhe me natyrë përgjithësisht më teknike, referuar neneve aktuale të projektligjit.

I. REKOMANDIME PARËSORE

I.1. Fragmentimi i kuadrit ligjor midis dy akteve normative

Projektligji rregullon financimin e partive politike vetëm jashtë periudhës së fushatës zgjedhore, duke lënë financimin e fushatave të rregulluar nga Kodi Zgjedhor. Kjo ndarje prodhon pasoja të drejtpërdrejta: mospërputhje të mundshme ndërmjet përkufizimeve të dy akteve, standarde të ndryshme transparence, boshllëqe në kontroll dhe mundësi reale për zhvendosje të të ardhurave apo shpenzimeve nga njëri regjim te tjetri. Financimi i partive jashtë fushatës dhe financimi i fushatës nuk janë dy fenomene të pavarura, të ardhurat, shpenzimet dhe subjektet e lidhura operojnë në vazhdimësi gjatë gjithë ciklit politik, ndaj dhe rregullimi duhet ta trajtojë çështjen e financimit politik si një të vetëm, në një akt të unifikuar.

Zgjidhja strukturore e preferuar, në këndvështrimin e KRIIK, shprehur në vijimësi, do të ishte **ndërtimi i një kuadri të unifikuar për financimin politik**, që të përfshijë njëkohësisht financimin vjetor dhe atë elektorale, kandidatët, subjektet e lidhura, palët e treta, shpenzimet online, raportimin, auditimin, mbikëqyrjen dhe sanksionet.

Nevoja për koherencë ndërmjet dy akteve bëhet edhe më e dukshme po të merret parasysh vetë mënyra se si funksionon raportimi financiar në praktikë. Kodi Zgjedhor e lidh shpenzimin e fushatës me qëllimin për të cilin kryhet dhe jo thjesht me momentin kohor të kryerjes së tij, ndërkohë që raportimi vjetor i partive politike përfshin veprimtarinë e zakonshme financiare të partisë. Në mungesë të një ndarjeje të qartë dhe të harmonizuar ndërmjet këtyre dy regjimeve, mbetet e paqartë se çfarë duhet të përfshihet në raportin vjetor të vetëdeklarimit, çfarë në raportin e financimit të fushatës, si dhe nëse veprimtaria financiare e fushatës duhet të paraqitet e detajuar në raportin vjetor apo vetëm si zë i

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

veçantë. Pikërisht për këtë arsye, KRIIK vlerëson se nevojitet koherencë e qartë normative ndërmjet këtij projektligji dhe Kodit Zgjedhor ¹.

Nëse kjo nuk realizohet në këtë fazë, minimumi i domosdoshëm do të ishte që hartimi i këtij ligji të shoqërohet me amendime të njëkohshme në Kodin Zgjedhor dhe me dispozita të shprehura harmonizuese ndërmjet dy akteve.

Në rastin e dytë, KRIIK rekomandon që **projektligji për financimin e partive politike të mos diskutohet e miratohet i izoluar, por të shoqërohet me diskutime shteruese e amendime të njëkohshme në Kodin Zgjedhor**, duke garantuar dispozita të qarta harmonizuese, me synim unifikimin e përkufizimeve, parimeve, standardeve të raportimit, auditimit dhe sanksioneve për të gjitha format e financimit politik. Vetëm në përfundim të këtij procesi të aprovohet një paketë e plotë ligjore nga Kuvendi.

I.2. Fuqizimi i rolit kontrollues të KQZ-së

Projektligji i njeh KQZ-së një sërë kompetencash: miratimin e formateve të raportimit, monitorimin, auditimin, vendosjen e sanksioneve, kërkimin e dokumentacionit dhe aksesin në databaza të institucioneve të tjera (kryesisht nenet 19 dhe 24). Megjithatë, neni 17, pika 5, formulon verifikimin e drejtpërdrejtë të financave si e drejtë dhe jo si detyrim: "KQZ-ja ka të drejtën të verifikojë drejtpërdrejt...". Kjo hapësirë gjuhësore lë hapësirë për pasivitet institucional, diskrecion dhe interpretim të ngushtë të kompetencave dhe shmangien e përgjegjësisë nga ana e KQZ-së.

Financimi i partive politike nuk është çështje thjesht administrative. Ai është i lidhur drejtpërdrejt me transparencën e jetës politike, barazinë e konkurrencës politike, integritetin e vendimmarrjes publike dhe besimin e publikut në vetë funksionimin e sistemit demokratik.. KQZ-ja duhet të konceptohet jo si organ që pret raportime, por si **institucion që ushtron kontroll aktiv, të pavarur dhe të detyrueshëm**.

Kontrolli nëpërmjet ekspertëve kontabël të jashtëm është instrument ndihmës i vlefshëm, por nuk mund të zëvendësojë mbikëqyrjen shtetërore. Në praktikë, ka rezultuar se raporti i kontrollit dhe verifikimit i hartuar nga KQZ-ja është mbështetur kryesisht në gjetjet e audituesve, pa pasqyruar në mënyrë të mjaftueshme hetimet ose verifikimet e kryera drejtpërdrejt nga vetë administrata e KQZ-së.

KRIIK rekomandon që **verifikimi i drejtpërdrejtë i financave politike të formulohet si detyrim ligjor i KQZ-së**, jo si e drejtë, dhe që ky detyrim të mbështetet me kapacitete të mjaftueshme njerëzore, teknike dhe financiare brenda organikës së KQZ-së, si dhe me **shkëmbim të detyrueshëm informacioni me institucionet kompetente në fushën fiskale, bankare, të pastrimit të parave dhe prokurimit publik**.

¹ Kodi Zgjedhor parashikon se shpenzim fushate është çdo shpenzimi i kryer nga partia politike për qëllime të fushatës, pavarësisht kohës se kur është kryer ai shpenzim. Praktika ka treguar që partitë deklarojnë në Raportet e Vetdeklarimit për fushatën zgjedhore të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e kryera nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në diën e zgjedhjeve. Në këto raporte, pergjithesisht, futen të gjitha shpenzimet e bëra nga partia duke përfshirë këtu edhe ato zëra, të cilat në periudha të tjera jo-zgjedhore, janë shpenzime apo të ardhura normale të partisë, pra që lidhen me aktivitetin financiar të zakonshëm.

Kjo situatë kërkon detyrimisht qartësim dhe koherencë mes parashikimeve ligjore, dhe mbi të gjitha, në gjykimin e KRIIK, përfshirjen në raportin vjetor të partisë politike edhe të raportit të fushatës zgjedhore të detajuar në zëra, në rastin e vitit zgjedhor, dhe jo si një zë i vetëm në bllok.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Madje mund të shkohet më tej, ku punonjësi i strukturës së posaçme brenda KQZ-së të mund të ketë akses të drejtpërdrejt (si user) në sistemet e institucioneve të tjera monitoruese dhe mbikqyrëse, për të lehtësuar ndërveprimin midis institucioneve dhe aksesin e menjëhershëm në informacion.

I.3. Shpenzimet nga palët e treta

Një boshllëk seriozi i projektligjit lidhet me mungesën e rregullimit të shpenzimeve të palëve të treta. Nëse individë, shoqëri tregtare apo organizata jofitimprurëse mund të kryejnë drejtpërdrejt shpenzime për publicitet politik, pa kaluar nëpërmjet partive politike, atëherë i gjithë regjimi i kufizimeve, raportimit dhe kontrollit të parashikuar nga projektligji bëhet lehtësisht i anashkalueshëm. Për këtë arsye, kjo çështje përbën një boshllëk me rëndësi të veçantë, me pasoja të drejtpërdrejta për transparencën, barazinë në garë dhe integritetin e financimit politik, veçanërisht nëse të tilla shpenzime kryhen gjatë periudhave elektorale apo edhe vetë fushatës zgjedhore, duke favorizuar parti apo kandidatë të caktuar.

Ndërkohë, edhe pse Kodi Zgjedhor aktual përmban disa ndalime lidhur me forma të caktuara të publicitetit gjatë fushatës zgjedhore,² këto ndalime mbeten të kufizuara dhe nuk adresojnë në mënyrë të plotë publicitetin politik të paguar në kuptimin më të gjerë. Në veçanti, ato nuk rregullojnë në mënyrë eksplicite shpenzimet për publicitet politik online, pavarësisht rolit gjithnjë e më të madh që ky lloj komunikimi ka në ndikimin politik, në orientimin e votuesve dhe në shmangien e mekanizmave klasikë të kontrollit financiar, por edhe forma të tjera të tij.

Për rrjedhojë, KRIIK vlerëson se kuadri ligjor duhet të **rregullojë shpenzimet e palëve të treta, me vëmendje të veçantë ndaj shpenzimeve të kryera gjatë periudhave zgjedhore**. Çdo person fizik ose juridik që kryen shpenzime për komunikime të paguara ose veprimtari të tjera të cilat synojnë ose mund të konsiderohen në mënyrë të arsyeshme se synojnë të favorizojnë ose dëmtojnë një subjekt zgjedhor, kandidat apo rezultat zgjedhor, duhet të regjistrohet në KQZ pas kalimit të një pragu të caktuar shpenzimi, të përdorë llogari bankare të posaçme, të raportojë burimin e të ardhurave dhe shpenzimet e kryera, si dhe t'i nënshtrohet kufijve të arsyeshëm të shpenzimit.

Çdo bashkërendim i këtyre veprimtarive me një subjekt zgjedhor ose kandidat duhet të **çojë në atribimin e shpenzimit te subjekti përfitues**. Dispozita nuk duhet të zbatohet

² Për ilustrim, ndalimi i tërthortë i reklamës/fushatës nga palë të treta del nga disa dispozita të lexuara bashkë të Kodit Zgjedhor: neni 2, pikat 28 dhe 31 e lidhin si shpenzimin e fushatës, ashtu edhe materialet propaganduese statike, vetëm me subjektin zgjedhor (“shpenzimet e bëra nga ose në emër të një subjekti zgjedhor”; “materialet që i shërbejnë subjektit zgjedhor”); neni 79, pikat 2–5 lejon posterat vetëm pranë zyrës së “partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës”, kërkon që çdo material të mbajë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...” me emrin e subjektit zgjedhor, dhe urdhëron heqjen e materialeve të vendosura në kundërshtim me këto kushte; neni 80, pika 1 dhe neni 83, pika 1 e rezervojnë minutazhin falas në median publike për partitë e regjistruara dhe KQZ-në; ndërsa neni 84, pika 4, është dispozita më e qartë, pasi parashikon se “vetëm subjektet zgjedhore të regjistruara për zgjedhje kanë të drejtë të transmetojnë reklama politike” dhe se reklama duhet të “identifikojë qartë subjektin porositës”. Nga leximi i kombinuar i këtyre normave rezulton se publiciteti politik gjatë fushatës lejohet vetëm kur lidhet juridikisht me një subjekt zgjedhor të regjistruar, çka përjashton në mënyrë të nënkuptuar reklamën e pavarur nga palë të treta.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

për shprehjen individuale të papaguar, veprimtarinë editoriale të medias, punën akademike, monitoruese ose kërkimore, si dhe për shprehjen qytetare mbi çështje publike që nuk synon drejtpërdrejt të favorizojë ose dëmtojë një subjekt zgjedhor apo kandidat.

Theksohet se ky rregullim propozohet në këtë projektligj dhe jo në amendime të mëvonshme që mund të kryhen në Kodin Zgjedhor, pasi i referohet komunikimit politik të paguar në përgjithësi, dhe jo atij me karakter strikt elektoral (fushatë), i cili indirekt rregullohet në Kodin Zgjedhor, së paku përsa i përket elementëve të fushatës tradicionale, por që gjithashtu ka nevojë për përmirësime dhe detajime të mëtejshme.

I.4. Publikimi i të dhënave financiare në format të hapur

Projektligji (veçanërisht neni 24) parashikon detyrime raportimi dhe publikimi, por nuk specifikon formatin në të cilin të dhënat duhet të vendosen në dispozicion të publikut. Kjo është një boshllëk i konsiderueshëm, sepse transparenca reale nuk varet vetëm nga ekzistenca e raportit, por edhe nga mënyra se si ai dorëzohet, plotësohet, përpunohet dhe bëhet i aksesueshëm.

Ligji nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik" vendos standardin e përgjithshëm që organet e sektorit publik të vënë dokumentet në dispozicion në format të hapur, të lexueshëm nga kompjuteri, të aksesueshëm dhe të ripërdorshëm, kur është e mundur dhe e përshtatshme. Megjithatë, neni 7, pika 3 e ligjit nr. 33/2022 i lë vetë organit diskrecionin për të përcaktuar listën e dokumenteve që ofrohen në format të hapur, ndërkohë që projektligji "Për financimin e partive politike" nuk përcakton detyrime për formatin.

Në këto kushte, pa një normë eksplicite për dorëzimin dhe publikimin e raporteve në format të hapur, KQZ-ja mbetet brenda këtij diskrecioni. Kjo është veçanërisht e rëndësishme po të merret parasysh se vetë KQZ-ja ka ndërmarrë në vijimësi përpjekje për raportimin ndëprmet platformave elektronike, të clat në vetvete synojnë pikërisht rritjen e standardit në përpunimin dhe publikimin e të dhënave.

Shqipëria, si anëtare e Open Government Partnership, ka marrë angazhime specifike për publikim proaktiv të informacionit me vlerë të lartë publike.³ Financimi i partive politike hyn pa dyshim në këtë kategori, ndaj **standardet e OGP-së përforcojnë arsyen për një detyrim të shprehur në mënyrë eksplicite në ligj.**

KRIIK rekomandon që projektligji të **parashikojë shprehimisht detyrimin e KQZ-së për publikimin e të dhënave financiare të partive politike në format të hapur dhe të lexueshëm nga kompjuteri**, sipas përkufizimit të këtyre të dhënave në ligjin 33/2022, duke përfshirë jo vetëm raportet përfundimtare, por edhe regjistrat, tabelat standarde dhe metadata.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

³ Open Government Partnership, Open Government Declaration, në: <https://www.opengovpartnership.org/how-we-work/joining-ogp/open-government-declaration/>

I.5. Përfshirja dhe adresimi i disa elementëve shtesë

a. Projektligji duhet të qartësojë në tërë përmbytjen e tij se në raportet vjetore duhet të paraqitet **i gjithë aktiviteti financiar i partisë i kryer brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**, pavarësisht nëse ai bëhet drejtpërdrejt nga partia politike, eksponentë apo anëtarë të saj, apo nga aktorë të tretë, qofshin këta rezidentë në Shqipëri apo në diasporë.

b. Projektligji duhet të përcaktojë specifikisht mënyrën e raportimit si një zë më vete në raportin financiar vjetor dhe në mënyrë tejet të detajuar **rastin e lobimit apo konsulencave që partitë politike, eskponentë të saj apo të tretë të lidhur me to, bëjnë me kompani apo individë, të huaj apo vendas**, me përfitues fundor insitucione qeveritare të huaja dhe institucione ndërkombëtare, duke siguruar që në çdo rast një kopje e kontratës së lidhur të depozitohet veçmas në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve. Të njëjtin regjim raportimi duhet të ndjekin edhe shpenzimet e bëra për konsulenca të marra nga kompani apo individë të huaj.

c. Projektligji duhet të manifestojë në tërë parashikimet e tij qëndrimin **për mos parashkrimin e veprave/shkeljeve që lidhen me aktivitetin financiar** të partive politike. Kjo kërkon ngritjen e kapaciteteve profesionale të strukturës së posaçme në KQZ, posedimin e tërë raporteve të plotë financiare, qoftë në kopje elektronike, qoftë në hardcopy, si dhe parashikimin e së drejtës dhe mundësisë për të denoncuar dhe hetuar/verifikuar çdo shkelje të konstatuar kryesisht prej KQZ-së, ose prej indicieve/denoncimeve nga qytetarë apo aktorë të tretë, pavarësisht kohës së kryerjes së veprës/shkeljes.

d. Projektligji **nevojitet të parashikojë dhe të nxisë partitë politike parlamentare**, me përgjësi direkte vendimmarrëse dhe kapacitete të plota të nevojshme, që të **publikojnë paraprakisht në faqet e tyre të internetit kostot kryesore të çdo aktiviteti** me akses dhe impakt tek publiku i gjerë, si dhe burimin e të ardhurave për këto shpenzime.

e. Një publik i informuar dhe i angazhuar është një mburojë e integritetit në financimin politik, rekomandon Rezoluta e Konferencës së 11-të të Shteteve të Palë të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit në dhjetor 2025.

Në funksion të këtij qëllimi madhor, Projektligji **nevojitet të inkurajojë qasjen e lehtë dhe të qëndrueshme/përhershme** të grupeve qytetare në të dhënat mbi financimin politik dhe **të sigurojë mbrojtje nga ngacmimet ose hakmarrjet kur këto grupe raportojnë** për keqpërdorime apo shkelje.

Po ashtu, projekt-ligji duhet të **inkurajojë bashkëpunimin e Strukturës së posaçme të KQZ-së** me median, grupet e vëzhgimit të zgjedhjeve, sektorin privat, dhe të këtyre të fundit me organet mbikëqyrëse të antikorrupsionit dhe autoritetet e zbatimit të ligjit.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

II. REKOMANDIME NEN PËR NEN

Neni 2 – Përkufizimet

II.1. Pika 5 – Përkufizimi i partisë politike

Formulimi aktual i pikës 5 rrezikon të kufizojë në mënyrë të panevojshme konceptin e partisë politike, duke e lidhur ekzistencën dhe funksionin e saj pothuajse ekskluzivisht me pjesëmarrjen në zgjedhje. Një qasje e tillë nuk është në përputhje me frymën e ligjit “Për partitë politike”, sipas të cilit partia politike përbën formë të organizimit politik të qytetarëve dhe nuk reduktohet vetëm në funksionin e saj elektoral.

Për këtë arsye, rekomandohet që **përkufizimi të riformulohet në mënyrë që të mos e kufizojë partinë politike vetëm te pjesëmarrja në zgjedhje**, por të mbahet përkufizimi aktual sipas Ligjit për Partitë Politike.

II.2. Pika 7 – Personat jo-rezidentë dhe rreziku i kontributeve nga diaspora

Numri i shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është shumë i madh. Kjo krijon mundësi reale që, nëpërmjet kontributeve të tyre, të kanalizohen fonde të cilat në praktikë janë të vështira për t’u verifikuar dhe kontrolluar nga institucionet shqiptare. Duke mos qenë rezidentë në Shqipëri, kontrolli efektiv mbi ta, nëpërmjet mekanizmave ligjorë që aktualisht janë në dispozicion, është dukshëm më i kufizuar.

Për këtë arsye, rekomandohet që kjo dispozitë të **rishikohet me kujdes dhe të shoqërohet me kërkesa shtesë verifikimi dhe raportimi**.

II.3. Pika 8 – Përkufizimi i shpenzimeve

Rekomandohet që në përkufizimin e shpenzimeve të shtohet edhe formulimi: **“dhe çdo shpenzim tjetër i vërtetuar se është kryer nga partia politike, strukturat e saj, ose nga të tretë në interes të saj, brenda apo jashtë vendit”**. Ky plotësim është i nevojshëm që të mos mbeten jashtë raportimit shpenzime të kryera realisht në interes të partisë, përfshi ato që mund të rezultojnë nga veprimtaria e strukturave të saj jashtë vendit ose nga subjekte të tretë që veprojnë në favor të saj.

II.4. Pika 9 – Shërbimet vullnetare dhe kontributet në natyrë

Formulimi aktual është tepër i gjerë dhe, i lënë pa kufizime të qarta, rrezikon të zhbëjë në praktikë gjithë logjikën e rregullimit të kontributeve në natyrë. Në këtë mënyrë, çdo shërbim apo mbulim shpenzimesh mund të paraqitet si “veprimtari vullnetare”, duke ulur në mënyrë fiktive kostot reale të partisë dhe duke krijuar, nga ana tjetër, marrëdhënie varësie apo ndikimi korruptiv.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Rekomandohet që dispozita të riformulohet në mënyrë më të ngushtë, duke përcaktuar qartë se cilat forma angazhimi mund të konsiderohen realisht vullnetare dhe cilat duhet të trajtohen si kontribute në natyrë dhe të raportohen si të tilla.

Nga ana tjetër, mënyra se si përkufizimi është formuluar përjashton nga përfshirja si të ardhura vetëm kohën e shpenzuar nga vullnetarët pa pagesë. Ndërkohë, Ligji 45/2016 “Për vullnetarizmin” përcakton disa detyrime financiare që i lindin ofruesit të vullnetarizmit (partisë politike në rastin konkret) në momentin që angazhon vullnetarë, të tilla si “pagesën e shpenzimeve të nevojshme për kryerjen e vullnetarizmit” (neni 21, pika 1.dh.) apo sigurimin e shëndetit për vullnetarin (neni 22). Në këto kushte, nevojitet që ligji, më së paku, të përcaktojë detyrimin e partive politike që të regjistrojnë dhe raportojnë numrin e personave, orëve të vullnetarizmit, dhe shërbimet e ofruara nga vullnetarët, duke mundësuar kryqëzimin mes këtyre të dhënave dhe raportimit të shpenzimeve të lidhura me to.

Neni 4 – Përdorimi i burimeve financiare dhe materiale

II.5. Aktivitetet me rrezik klientelist

Neni 4, pika 1, shkronja "dh" lejon "çdo aktivitet tjetër... që promovon programin, veprimtarinë dhe objektivat e partisë politike". Ky formulim tepër i gjerë mundëson justifikimin e çdo shpenzimi nën ombrellën e "promovimit të objektivave". Lista e qëllimeve të lejuara nuk është e mbyllur dhe nuk e parandalon shpërndarjen e përfitimeve me karakter klientelist.

Ndër aktivitetet me rrezik të lartë keqpërdorimi, KRIIK konsideron aktivitetet e bamirësisë dhe dhënien e ndihmave materiale për individë apo komunitete (praktikë e dokumentuar të ketë ndodhur pas fatkeqësive natyrore), apo financimi i infrastrukturës publike lokale me logon e partisë apo nën patronazhin e kandidatëve/eksponentëve politikë, me efekt të drejtpërdrejtë elektoral, qoftë ky i menjëhershëm apo i mëvonshëm.

Rekomandohet që pika 1 e nenit 4 të plotësohet me dispozitë eksplicite, sipas së cilës **burimet e partisë nuk mund të përdoren për asnjë formë shpërndarjeje përfitimesh materiale, ndihmash apo mbështetjesh me karakter bamirësie, humanitar apo klientelist, pavarësisht nga etiketimi i tyre si aktivitet partiak.**

Partia politike nevojitet të qëndrojë dhe përmbushë misionin e saj të nxitjes dhe krijimit të opinionit publik, në këtë rast, në mbështetje të mekanizmave apo institucioneve me natyrë bamirësie, humanitare, etj, por pa i zëvendësuar ato apo marrë rolin e tyre.

II.6. – Sqarimi i pikës 1.dh

Neni 4, pika 1,dh përdor formulimin “media publike dhe/ose sociale”, pa e bërë të qartë nëse me “media publike” synohen mediat audiovizive publike, mediat në pronësi publike, apo komunikimi publik në kuptim më të gjerë. Gjithashtu, nuk është e qartë nëse mediat online trajtohen si kategori më vete apo konsiderohen të përfshira në këtë formulim.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Për këtë arsye, **rekomandohet që dispozita të qartësohet terminologjikisht dhe të përdorë togfjalëshin “në mjetet e informimit masiv publik”**, për të ruajtur koherencën me termat e përdorur në projekt-ligj. Pra, gërma: “(dh) çdo aktivitet tjetër, përfshire edhe veprimtarinë në mjetet e informimit masiv publik që promovon programin, veprimtarinë dhe objektivat e partisë politike”.

Neni 5 – Ndalimi i ushtrimit të presionit

II.7. Plotësimi i pikës 2: të ndalohet edhe dhënia, jo vetëm premtimi

Neni 5, pika 2 ndalon vetëm premtimin e privilegjeve apo përfitimeve personale që rrjedhin nga burime shtetërore. Norma mbetet e cunguar: ndalon fazën paraprake të sjelljes, por jo realizimin e saj.

Rekomandohet që neni 5, pika 2, të riformulohet në mënyrë që **të ndalohet jo vetëm premtimi, por edhe dhënia, mundësimi dhe përfitimi, i drejtpërdrejtë apo i tërthortë.**

Neni 6 – Burimet financiare dhe materiale

II.8. Huatë dhe kreditë me kushte preferenciale

Neni 6, shkronja "ç" lejon huatë dhe kreditë si burim financimi pa vendosur asnjë standard mbi kushtet e tregut, duke lënë të hapur kanalet për financim të maskuar.

Rekomandohet që të përcaktohet se **partia politike nuk mund të marrë hua apo kredi me kushte preferenciale, por vetëm me kushte tregu, duke marrë në konsideratë normat e interesit, komisionet, afatin, garancitë, kolateralin dhe penalitetet.**

Në plotësim të kësaj norme, nevojitet të përcaktohet se **çdo avantazh ekonomik që rrjedh nga kushte më të favorshme se tregu konsiderohet kontribut financiar ose përfitim në natyrë dhe i nënshtrohet detyrimeve të raportimit si i tillë.**

Neni 7 – Ndalimi i ndihmave financiare dhe materiale

II.9. Rasti i ortakëve me pjesëmarrje të shpërndarë, por me kontroll real

Neni 7, pika 1, shkronja "ë" ndalon dhurimet nga personat juridikë vetëm kur ortaku zotëron mbi 50% të kapitalit. Ky formulim është tepër i ngushtë. Dy ortakë me nga 40% secili, ose ortakë të lidhur me kontroll të përbashkët, bien jashtë ndalimit edhe pse rreziku është i njëjtë.

Rekomandohet që **dispozita të riformulohet mbi bazën e kontrollit real, të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, përmes ndikimit vendimtar, veprimt të përbashkët të ortakëve të lidhur, apo zotërimit nëpërmjet shoqërive të ndërmjetme, dhe jo mbi bazën e shumicës formale të kapitalit.**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

II.10. Dhuratat dhe ndihmat nga parti apo fondacione politike të huaja

Neni 7, pika 2 lejon ndihmat nga parti dhe fondacione politike të huaja për qëllime të hapura, duke përfshirë shprehjen "etj.", pa përcaktuar kufij mbi qëllimin, procedurën dhe kontrollin.

Rekomandohet që kjo dispozitë të detajohet duke **përcaktuar shprehimisht dhe në mënyrë shteruese se ndihmat lejohen vetëm për qëllime të kufizuara** (p.sh. bashkëpunim politik, trajnim, demokratizim, barazi gjinore, të drejta njeriu); **në asnjë rast nuk mund të përdoren për fushatë zgjedhore ose mbështetje të kandidatëve**; çdo ndihmë **të deklarohet paraprakisht në KQZ** me identifikimin e dhuruesit, qëllimit, shumës dhe periudhës; dhe **çdo devijim nga qëllimi i lejuar të sjellë kthimin e fondeve dhe sanksionet përkatëse.**

Po ashtu, rekomandohet që **ligji të përcaktojë edhe një kufi maksimal të lejueshëm për këto ndihma**, me qëllim që mbështetja nga subjekte politike të huaja të mos marrë përmasa të tilla që të krijojnë varësi financiare apo ndikim të tepruar mbi veprimtarinë politike të partisë përfituese.

II.11. Pika 1, shkronjat “d”, “dh”, “e”, “ë”, “h” dhe “g”,

Për të qenë efektive, ndalimet e parashikuara në nenin 7 duhet të riformulohen dhe të qartësohen më tej. Konkretisht:

Në shkronjën “d”, **ndalimi duhet të shtrihet jo vetëm te vetë subjektet juridike, por edhe te pronarët e tyre, të afërmit e pronarëve, drejtuesit, administratorët dhe të afërmit e tyre, pasi ekziston rrezik real përdorimi si kanal i tërthortë financimi.**

Në shkronjën “dh”, **termat e përdorur “entet dhe shoqëritë tregtare vendase publike” duhet të përkufizohen shprehimisht te neni 2 “Përkufizime”, për të shmangur paqartësi në zbatim.**

Në shkronjat “e” dhe “ë”, duhet të qartësohet formulimi “që kanë dhe deri në 3 vite”, si dhe **të rishqyrtohet vetë afati 3-vjeçar, duke vlerësuar se do të ishte më e përshtatshme zgjatja e tij në 5 vite**, në mënyrë që të mbulohet së paku periudha kohore e një legjislature.

Nuk kuptohet përse është konkluduar në kufizimin vetëm për një afat 3 vjeçar, ndërkohë që mbetet hapur mundësia e krijimit të një lidhje klienteliste apo korruptive dhe prodhimit të efekteve të saj brenda periudhës 4 vjeçare të një mandati pushteti.

Në shkronjën “g”, sugjerohet **të shtohet formulimi “dhe/ose për të cilët është filluar procedurë”, me qëllim që dispozita të mos limitohet vetëm në rastin e fillimit të procedurës së ekzekutimi të detyrueshëm nga shërbimi i përmbarimit.**

Gjykohet se vetëm fakti i të qenit debitor ndaj institucioneve të Republikës së Shqipërisë është mëse e mjaftueshme për të ndaluar çdo ndihmë financiare apo materiale ndaj partisë politike. Kjo jo vetëm si një qasje moraliste në dobi të ruajtjes së integritetit politik nga moszbatues apo shkelës të ligjit, por edhe për të shmangur çdo ndikim në politikë dhe çdo marrëdhënie të mundshme klienteliste apo korruptive që mund të vendoset.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Në shkronjën "h" ndalohen dhurimet nga shtetas të dënuar për vepra penale në disa fusha, por vetëm për personin fizik të dënuar, jo për personin juridik që ajo/ai mund të kontrollojë. Rekomandohet që dispozita të zgjerohet duke **ndaluar gjithashtu dhurimet nga personat juridikë ku personi i dënuar sipas kësaj shkronje zotëron, drejtpërdrejt ose tërthorazi, kontroll mbi shoqërinë, qoftë nëpërmjet zotërimit të kuotave, të drejtës së votës apo ndikimit vendimtar mbi organet drejtuese.**

II.12. Pika 3: Modalitetet e bashkëpunimit

Pika 3 duhet të qartësojë më mirë detyrimin për bashkëpunim të qëndrueshëm dhe periodik ndërmjet KQZ-së dhe institucioneve të tjera, duke përfshirë afate, modalitete dhe shkëmbim të rregullt informacioni.

Madje, mund të konsiderohet e drejta e KQZ-së (strukturës së posaçme që merret me monitorimin dhe kontrollin e financave) që të ketë akses të drejtpërdrejt për të marrë informacion në databazat e institucioneve respektive, si drejtoria e tatimeve, ILDKPI, Agjencia e Inteligjencës Financiare, etj.

Neni 9 – Modalitetet për financimin e partisë politike

II.13: Të qartësohet termi “të gjitha të ardhurat”

Në lidhje me nenin 9, pika 1, nevojitet të qartësohet nëse termi “të gjitha të ardhurat” përfshin edhe mbështetjen publike në natyrë, si p.sh. përdorimin e selive, zyrave apo asetëve të tjera shtetërore që mund tu vendosen në dispozicion partive politike.

Sa më sipër përbëjnë përfitime materiale me vlerë monetare dhe nuk duhet të mbeten jashtë mekanizmave të kontrollit, por të deklarohen si të ardhura publike në natyrë dhe të pasqyrohen në raportim.

II.14. Paqartësia e formulimit mbi llogaritë bankare

Neni 9, pika 3 thotë "Si rregull partitë politike duhet të kenë një llogari të vetme në një bankë dhe kur nuk është e mundur mund të hapin llogari në çdo bankë tjetër të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë përmes të cilave kryejnë të gjitha transaksionet"; formulim i paqartë ky pasi nuk kuptohet se çfarë nuk është e mundur (të ketë një llogari apo të ketë vetëm një llogari?).

Në këtë pikë gjykohet se nevojitet të specifikohet qartë se partia politike mund të ketë vetëm një llogari në një ose më shumë banka të nivelit të dytë, duke hequr termin “si rregull” nga dispozita.

Në rast të mbajtjes së termit jo përjashtues “si rregull”, rekomandohet që dispozita të qartësohet duke parashikuar qartë detyrimin për të paktën një llogari kryesore të regjistruar pranë KQZ-së dhe deklarim paraprak të çdo llogarie shtesë në atë bankë apo në çdo bankë tjetër, duke arsyetuar në çdo rast nevojën për këtë llogari shtesë. Në çdo rast partia politike duhet të bëjë identifikim të plotë të të gjitha llogarive të përdorura prej saj pranë KQZ-së..

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

II.15. Pika 2 dhe pika 4 – Vlera e tregut dhe detyrimet deklarative për kuotat e anëtarësisë

Rekomandohet që neni 9, pika 2 të qartësojë shprehimisht se vlera e mallrave apo shërbimeve të dhuruara duhet të **pasqyrohet sipas vlerës së tregut në kohën e lëshimit të deklaratës apo faturës.**

Po ashtu, pika 4 duhet të plotësohet në mënyrë që në momentin e derdhjes në bankë të kuotizacioneve ato të shoqërohen më një **deklaratë të partisë.**

Deklarata për kuotat e anëtarësisë të përmbajë jo vetëm shumën e përgjithshme, por edhe datat e derdhjes së kuotizacioneve dhe numrin e anëtarëve që kanë kontribuar, sipas regjistrimit të partisë politike.

Për të shmangur përdorimin abuziv të zërit “kuota anëtarësie”, **nevojitet që kuotat të regjistrohen në një Regjistër të Posaçëm, të standardizuar dhe të miratuar nga KQZ-ja, i cili të dorëzohet së bashku me raportet e vetëdeklarimit financiar të partive.**

Po ashtu, partia politike duhet të ketë detyrimin të mbajë dhe, së paku për qëllime verifikimi institucional, **të depozitojë pranë KQZ-së Regjistrin e Anëtarësisë** ose të dhëna të mjaftueshme verifikuese mbi të. Kjo është e nevojshme sepse, në mungesë të një regjistri të verifikueshëm të anëtarësisë, përdorimi i kuotave mbetet lehtësisht i manipulueshëm⁴: shuma të ndryshme mund të deklarohen si kuota anëtarësie pa pasur mundësi kontrolli nëse pagesa është bërë realisht nga anëtarë të partisë dhe se vlera është në përputhje me statutin e partisë.

Në rast se pagesi nuk është anëtar, shuma duhet të trajtohet si donacion dhe t’u nënshtrohet kufizimeve përkatëse.

II.16. Harmonizimi i pikave 4 dhe 5

Pika 4 kërkon transaksione bankare për të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet me përjashtim të kuotave të anëtarësisë. Pika 5 lejon dhurime cash deri në 50,000 lekë. Këto dy dispozita bien ndesh me njëra-tjetrën dhe dobësojnë gjurmueshmërinë financiare.

Rekomandohet që **të përcaktohet një regjim unik.** Në kushtet e kontekstit të sotëm, me një informalitet të lartë, korrupsion madhor, prezencë të krimit të organizuar dhe të sasisë së madhe të parasë cash në qarkullim, **çdo dhurim ndaj partisë politike të bëhet vetëm nëpërmjet transaksionit bankar.**

Në këtë mënyrë, **dhuruesit e shumave financiare nëpërmjet bankës në çdo rast do të duhet të plotësojnë deklaratën e parashikuar në nenin 10 pika 2, duke deklaruar se janë në kushtet e respektimit të parashikimeve (ndalimeve) të nenit 7 të projekt-ligjit.**

Konsiderohet e domosdoshme që **vetëm mbledhja e kuotave të anëtarësisë të lejohet të bëhet me para cash**, ndërkohë që lidhur me derdhjen e tyre në bankë të ndiqet procedura e paraqitur në pikën II.15.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

⁴ Problematika e deklarimit të kuotave, një vit me zero lekë dhe vitin tjetër miliona lekë, është një problematikë madhore. Ky zë përherë është deklaruar pa asnjë specifikim shtesë dhe pa asnjë mundësi verifikimi konkret. Kjo shumë e konsiderueshme shpesh transferohet në llogarinë e partisë për fushatë pa patur asnjë mundësi kontrolli apo verifikimi. Shpesh është konstatuar se vlera e kuotave nuk ka qenë në koherencë me parashikimet e përcaktuara në statutet përkatëse apo numrin e anëtarësisë të bërë publik, kur ka patur ndonjë deklaratë të tillë.

Një rregullim i tillë do të ishte më në përputhje me objektivin e gjurmueshmërisë së transaksioneve, kufizimin e përdorimit të parasë cash apo me pengimin e pastrimit të parave në financimin politik sipas rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare.

II.17. Pika 6 – fondet e marra pa vullnetin e partisë

Detyrimi për njoftim dhe transferim lidhet vetëm me rastin kur fondet i vihen në dispozicion partisë "pa vullnetin" e saj, formulim i ngushtë që lë hapësirë për interpretim.

Rekomandohet që pika 6 të riformulohet duke parashikuar **detyrimin e njoftimit dhe transferimit në çdo rast kur partia merr, zbulon apo konstaton se ka marrë fonde në kundërshtim me ligjin, pavarësisht nga vullneti i saj për t'i pranuar** (për shembull: nëse fondet janë pranuar për shkak të një gabimi njerëzor: nëse partia ka zbuluar vetë më vonë se donacioni i marrë është në kundërshtim me parashikimet e lejuara nga ligji, etj.)

Neni 10 – Kontributet për subjektet politike

II.18. Vetëdeklarimi i donatorëve pa mekanizëm verifikimi

Neni 10, pika 2 kërkon vetëm nënshkrimin e një deklaratë nga dhuruesi. I gjithë sistemi i ndalimeve të nenit 7 bazohet kështu tërësisht mbi vetëcertifikim: partia nuk ka asnjë detyrim ligjor verifikimi; KQZ-ja nuk ka mekanizëm automatik kontrolli. Ndalimi formal mund të anashkalohet nëpërmjet deklaratave të rreme, ndërkohë që partia mbrohet me argumentin e mungesës së dënjës.

Rekomandohet që **partia të ketë detyrim aktiv verifikimi minimal të paktën për dhurimet mbi një prag të caktuar**, nëpërmjet regjistrave publikë; **KQZ-ja të ketë akses ndërinstucional me regjistrat e prokurimit, dënimeve penale dhe deklaratave tatimore; dhe partia të mbajë përgjegjësi administrative edhe kur ka pranuar deklaratë të rreme, nëse nuk ka kryer verifikimin minimal.**

Për më tepër, duhet të shqyrtohet edhe **detyrimi i KQZ-së për të verifikuar**, kur kjo është e zbatueshme, nëse personi fizik ose juridik i ka pasqyruar këto dhurime në dokumentacionin e vet financiar ose tatimor.

Në rastin e personave juridikë, **dhurimet duhet të kryhen përmes transaksionit bankar nga llogaria e vet subjektit juridik të llogaria e partisë politike**, në mënyrë që gjurmueshmëria dhe identifikimi i burimit të jenë të plota.

Po ashtu, KRIIK vlerëson se **kufijtë maksimalë të kontributeve të lejuara sipas këtij neni duhet të rishqyrtohen, me mundësinë e përgjysmimit të tyre.**

Financimi i partive politike nuk duhet të mbështetet në mënyrë disproporcionale të kontributet e larta individuale duke u ekspozuar ndaj ndikimeve, por të pjesëmarrja e gjerë e anëtarësisë. Në këtë kuptim, thelbi i rregullimit duhet të jetë **forcimi i rolit të kuotave të anëtarësisë, si forma më e shëndetshme e financimit politik**, sepse rrit pjesëmarrjen, forcon lidhjen e partisë me anëtarët e saj dhe shton llogaridhënien e saj ndaj tyre. Kjo qasje i shërben më mirë idesë së barazisë së peshës ekonomike të secilit anëtar në jetën e brendshme politike të partisë.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Neni 11 – Fondi publik për mbështetjen e partive politike

II.19. Përfshirja në deklaram dhe financimit në natyrë

Krahas fondeve monetare të alokuara çdo vit nga buxheti i shtetit, **nevojitet të merret në konsideratë edhe mbështetja publike në natyrë që partitë politike mund të kenë në përdorim**, si p.sh. seli, zyra apo asete të tjera shtetërore. Edhe kur këto nuk jepen në formën e transferimit monetar, ato përbëjnë përfitime me vlerë ekonomike dhe, për këtë arsye, **duhet të deklarohen dhe të pasqyrohen si mbështetje publike në natyrë**, në mënyrë që të mos mbeten jashtë mekanizmave të transparencës dhe kontrollit.

II.20. Formula e shpërndarjes dhe pluralizmi politik

Formula aktuale e financimit publik (70% sipas numrit të deputetëve, 20% ndërmjet partive parlamentare dhe atyre me mbi 10,000 vota, 10% sipas përqindjes elektorale) reflekton në mënyrë dominuese peshën e mandateve parlamentare ekzistuese në raportin 90% partitë parlamentare dhe 10 % për partitë parlamentare dhe ato që kanë marrë më shumë 1% në shkallë vendi të ndarë proporcionalisht sipas përqindjes së marrë. Kjo logjikë asimetrike ka një efekt të dyfishtë: konsolidon financiarisht partitë tashmë në parlament dhe redukton maksimalisht konkurrencën politike, bazuar kjo edhe në sistemin elektoral të sotëm.

Ky kuadër nuk konsiderohet aspak në përmbushje me çfarë deklarohet në Relacionin e projekt-ligjit, konkretisht në Kreun I. *“Qëllimi i projektaktit dhe objektivat që synohen të arrihen”*, pika 3. *“Përmirësimi i barazisë në konkurrencën politike”*, ku thuhet se *“Përmes formulës së detajuar të shpërndarjes së fondeve publike, projektligji synon të krijojë kushte të drejta financiare midis partive politike. Rishpërndarja bazohet në përfaqësimin parlamentar, numrin e votave dhe pjesëmarrjen në proceset zgjedhore, duke siguruar mbështetje të qëndrueshme për partitë e vogla, por edhe duke vendosur kritere të qarta meritokracie. ...”*.

Financimi publik duhet të synojë jo vetëm stabilitet institucional, por edhe nxitjen e pluralizmit politik.

Rekomandohet që **formula të rishikohet me synim uljen e peshës së mandateve parlamentare dhe rritjen e rolit të votës si tregues i mbështetjes reale elektorale**, duke krijuar një komponent më të gjerë mbështetjeje që nuk përjashton në mënyrë disproporcionale partitë joparlamentare që marrin pjesë në zgjedhje dhe arrijnë të marrin mbështetje domethënëse prej votuesve

Ligji për Partitë Politike, në nenin 5 të tij parashikon se “veprimtaria e partive politike mund të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose në disa njësi të ndarjes administrative territoriale të vendit”, duke i dhënë hapësirë akoma më shumë pluralizmit dhe mendimit politik qoftë edhe vetëm në disa njësi administrative të vendit.

Një parti e tillë do ta kishte shumë të vështirë të përfitonte ndihmë financiare nga shteti me rregullimin aktual dhe panoramën e sotme zgjedhore në vend.

E njëjta gjë vlen edhe për partitë politike të vogla, të cilat jo vetëm që nuk favorizohen nga sistemi i ngritur nga dy partitë e mëdha, por me zorr arrijnë të mbijetojnë në sistemin politik duke u detyruar të (sh)përdoren prej këtyre të fundit në funksion të lojërave

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

elektorale të tyre, ndërkohë që ekzistenca e tyre mund dhe duhet të përbëjë në vetvete një pasuri shtesë opinionbërëse dhe qëndrim-orientuese për shoqërinë tonë.

Ky këndvështrim pozitiv ndaj tyre mungon. Madje projekt-ligji parashikon edhe një sërë detyrimesh mbi transparencën e financimit, organizimin e brendshëm apo edhe sanksione të cilat për partitë e vogla implikojnë kosto që për to janë rrënuese.

Një qasje e tillë nuk do ta ndryshojë aspak situatën problematike aktuale, por do të çojë drejtpërdrejt në një klimë e sjellje paligjshmërie të tyre duke afektuar tërë rregullimin dhe efektivitetin e ligjit, si dhe dëmtuar akoma edhe më pluralizmin në vend.

Ndërsa ky projekt-ligj parashikon kufizime deri në mospjesëmarrjen e tyre në zgjedhje, **Rekomandohet se nevojitet së pari që shteti dhe sistemi i ngritur tu japë më parë incentiva e mbështetje** për përmbushjen me dinjitet dhe lehtësi të detyrimeve ligjore menjëherë sapo partia politike të jetë krijuar e të tregojë se ajo arrin të marrë së paku 3000 vota, i cili mund të quhet si “pragu i moralitetit” të të qenit parti politike, aq sa është numri minimal i nevojshëm i mbështetësve për themelimin e një partie, por edhe për ekzistencën e gjallë të saj. Kalimi i këtij pragu prej një partie politike i jep asaj integritet të plotë e të qëndrueshëm në pikëpamje të plotësimin të kushtit ligjor për të qenë një parti politike e gjallë në jetën aktive politike, çka do të thotë që misioni dhe veprimtaria e saj vijon të jetë e vlerësuar dhe tërheqëse ndër ofertat politike që paraqiten në zgjedhje.

Ngarkimi në këtë moment me detyrime dhe kosto të panumërta, duke filluar nga kostot për mbajtjen të hapur të një llogarie bankare, kostot operative e organizative e deri në atë të një faqeje funksionale interneti, e paralizojnë dhe e mbysin *de facto* këtë ofertë politike, pasi vetëm kuotizacionet e anëtarëve janë në çdo rast të pamjaftueshme për përballimin e këtyre kostove vjetore. Nga ana tjetër, një situatë e tillë e ekspozon këtë formacion të ri politik, ndaj nevojës për tu bërë pjesë e marrëdhënieve klienteliste apo pre e donacioneve me natyrë të dyshimtë, duke zhbërë kështu integritetin e vetë partisë e misionit të saj, dhe duke përbërë nga ana tjetër një rrezik akoma më madhor për jetën politike dhe ofertat elektorale në vend.

Ndaj gjykohet dhe **rekomandohet se mbështetja financiare nga buxheti i shtetit për të gjitha partitë që arrijnë pragun prej 3000 votash në zgjedhjet parlamentare** jo vetëm që është një ndihmë e drejtpërdrejtë për integritetin moral e politik të ofertës politike e elektorale në vend, por përbën edhe një inkurajim të mëtjetshëm ndaj themeluesve dhe mbështetësve të partisë së re / të vogël politike që idetë dhe platformat e tyre t’i çojnë përpara duke i propoganduar e rritur më tej informimin, opinionbërjen dhe ofertën politike në vend.

KRIIK rekomandon që fondi vjetor të shpërndahet në këtë mënyrë: a) 50% sipas numrit të deputetëve; b) 20% ndërmjet partive parlamentare dhe atyre me mbi 10,000 vota; c) 30% ndërmjet partive parlamentare dhe atyre me mbi 3000 vota.

Një zgjidhje e tillë do t’i shërbente më mirë parimit të nxitjes së pluralizmit dhe financimit më të barabartë të subjekteve që kanë dëshmuar mbështetje elektorale reale.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Mos arritja e mbështetjes në zgjedhje në pragun e 3000 votave, i jep moralisht të drejtë kufizimit të përfitimeve duke çuar si pasojë deri edhe në mospjesëmarrjen e partisë respektive në zgjedhje, pasi konstatohet *de-facto* mosmbështetja më as me numrin minimal të mbështetësve / anëtarëve themelues të asaj partie.

II.21. Pika 6 – Fondet për barazinë gjinore dhe të rinjtë

Granti 5% parashikohet si shtesë mbi fondin publik ekzistues, jo si pjesë e kushtëzuar e tij. Një qasje e tillë i “shpërblen” partitë politike në rast se ato do të duan të nxisin mbështetjen dhe fuqizimin e grave dhe të rinjve në politikë, ndërkohë që në një shoqëri të drejtë dhe demokratike ky duhet të jetë një qëllim primar, madje i detyrueshëm, i partive politike.

Nga ana tjetër, **konsiderohet mangësi që nuk përmenden të tjera shtresa të nënpërfaqësuar që partitë politike duhet të fuqizojnë**, duke e kufizuar rritjen e pjesëmarrjes vetëm tek gratë dhe të rinjtë.

Rekomandohet që të parashikohet se **përqindja e të ardhurave që duhet të shkojë për forcimin e barazisë gjinore dhe përfshirjes së të rinjve në politikë të plotësohet me detyrimin për të fuqizuar përfaqësimin e të tjerave grupe të nënpërfaqësuar.**

Ky fond duhet të jetë një **fond i kushtëzuar brenda financimit publik që partia përfiton tashmë** dhe jo shtesë; partia të ketë **detyrim raportimi të posaçëm mbi përdorimin e tij**; dhe në rast mospërdorimi ose përdorimit për të tjera qëllime, shuma të kthehet në buxhetin e shtetit.

II.22. Pika 7 – Indeksi i fondit publik nga Këshilli i Ministrave

Neni 11, pika 7 i jep Këshillit të Ministrave kompetencën e indeksimit çdo dy vjet, me tavan një pikë përqindje mbi inflacionin e targetuar. Kjo i jep ekzekutivit diskrecion të drejtpërdrejtë mbi financimin e partive, duke përfshirë partitë opozitare, pa garanci procedurale kundër mosindeksimit selektiv ose të vonuar. Vlen të theksohet se neni 11, pika 8 parashikon rishikim parlamentar çdo 4 vjet. Rishikimi 4-vjeçar nga Kuvendi dhe indeksimi nga ekzekutivi janë dy procese me objekt dhe logjikë të ndryshme, ku ky i fundit mbetet i pakontrolluar nga i pari.

Rekomandohet që **mekanizmi i indeksimit të jetë automatik dhe i lidhur me tregues objektivë** si indeksi i çmimeve të konsumit i INSTAT-it; dhe **të parashikohen afate të detyrueshme dhe garanci procedurale kundër bllokimit.**

Neni 13 – Raportimi financiar

II.23. Pika 4 – Paqartësia lidhur me raportimin e fushatës zgjedhore

Neni 13, pika 4 thotë se raportet e partisë dorëzohen "bashkë me raportin financiar të fushatës zgjedhore", pa sqaruar nëse ky i fundit është pjesë integrale e raportit vjetor apo një dokument i veçantë (p.sh. do të ri-dorëzohet raporti financiar i zgjedhjeve i parashikuar në Kodin Zgjedhor së bashku me raportin vjetor, apo do të konsiderohet i dorëzuar.).

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Konsiderohet e domosdoshme që, në funksion të transparencës së plotë dhe moskrijimit të pengesave artificiale në shqyrtimin integral të raportit vjetor dhe kryerjes së kontrollit apo kryqëzimeve të nevojshme, **raporti i fushatës zgjedhore të jetë pjesë integrale e raportit financiar vjetor**, duke mundësuar dallimin e qartë midis zërave të aktivitetit të

zakonshëm përgjatë vitit dhe zërave të aktivitetit të lidhur me fushatën zgjedhore të zhvilluar gjatë atij viti.

Qëllimi i ligjit duhet të përmbushet tërësisht **duke bërë transparencë të plotë mbi çdo aktivitet financiar të kryer, të detajuar në zëra, në mënyrë të plotë e integrale**, pa vijuar përvojën e raportimit të fushatës në bllok e të raportimeve të dubluara, të padetajuara e shpesh të pakuptueshme për aktorët e tretë e publikun e gjerë.

II.24. Pika 5 – Saktësimi i natyrës së Raportit të KQZ-së

Projekt-ligji duhet të përcaktojë qartë rolin aktiv monitorues e mbikqyrës të KQZ-së nëpërmjet strukturës së posaçme të saj, **produkt i të cilit duhet të jetë edhe Raporti Monitorues i KQZ-së**, i parashikuar në pikën 5 të nenit 13 të ligjit, i cili parashikohet të publikohet bashkë me raportet e tjera, 30 ditë pas dorëzimit të tyre nga partia politike.

Ky raport duhet të përmbledhë gjetjet paraprake të bëra nga shqyrtimi i hollësishëm *prima-facia* pas dorëzimit të raporteve prej partive politike, si dhe kryerjes së kryqëzimeve apo investigimeve të nevojshme, nisur edhe nga të dhënat / indiciet / denoncimet e marra kryesisht nga vetë KQZ-ja, nga denoncimet e qytetarëve apo aktorëve të tretë. Në këtë rast, duhet të jetë ky raport i cili i vihet në dispozicion paraprakisht edhe audituesve ligjorë në momentin e fillimit të procesit të auditimit të partive politike sipas shortit të hedhur.

Neni 14 – Tatimi i të ardhurave

II.25. Pika 2 – Dorëzimi i raportit financiar vjetor edhe organeve tatimore

Legjislacioni tatimor nuk i përjashton partitë politike nga detyrimi për të dorëzuar raportet financiare vjetore (pasqyrat financiare) të tyre pranë organeve tatimore, sikurse çdo organizatë jofitimprurëse, siç janë edhe partitë politike, në Republikën e Shqipërisë.

Partitë politike, sikurse çdo subjekt i regjistruar pranë organeve tatimore kanë NIPT si dhe gëzojnë një kod NACE (nga frëngjishtja: Nomenclature statistique des activités économiques dans la Communauté européenne) në regjistrat e organeve tatimore, kod i cili përcakton natyrën e aktivitetit ekonomik të subjektit.

Në rastin kur subjekti / partia politike kryen aktivitet ekonomik, qoftë ky edhe jofitimprurës, sikurse parashikohet në nenin 8 pika 2 dhe në nenin 14 të projekt-ligjit, atëherë **partia politike është i detyruar që një kopje të raportit vjetor financiar ta dorëzojë pranë organeve tatimore**, të cilat duhet të përmbushin përgjegjësitë e tyre ligjore lidhur me kontrollin ndaj aktivitetit ekonomik të kryer, si dhe pagimin e tatim/taksave lidhur me të.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Lidhur me sa më sipër, **rekomandohet që Ligjvënësi dhe ky projekt-ligj të qartësojë këtë dualitet detyrimi duke nxitur korrektësi dhe ligjzbatim të plotë të kuadrit ligjor për dorëzimin e raporteve financiare vjetore (pasqyrat financiare vjetore).**

Gjithashtu, duhet konsideruar rasti kur partitë politike kryejnë aktivitet ekonomik e duhet të vënë në dispozicion pasqyrat vjetore financiare e të mund të kontrollohen lidhur me këtë aktivitet nga organet tatimore, kompetencat dhe përgjegjësitë e të cilëve nuk mund të mbulohet as nga KQZ-ja dhe as nga auditët ligjorë.

Neni 15 – Kontrolli i brendshëm

II.26. Publikimi në faqen e partisë i të dhënave të kontrollit të brendshëm

Rekomandohet që të dhëna të kuptueshme mbi përmbajtjen dhe zbatimin e detyrimeve të këtij neni të publikohen në faqen e internetit të partisë politike. Transparenca mbi kontrollin e brendshëm nuk duhet të mbetet vetëm çështje e organizimit të brendshëm, por duhet të jetë e aksesueshme edhe për publikun, sidomos kur partia përfiton fonde publike.

Për këtë arsye, KRIIK sugjeron gjithashtu që **çdo parti politike e financuar nga buxheti i shtetit të ketë detyrimisht një faqe interneti publike funksionale.**

Është konstatuar se një pjesë e shkeljeve të evdientuara lidhen në mënyrë të drejtpërdrejt me mospërgjigje ndaj drejtimit menaxherial dhe politik të partisë prej organeve të saj, degëve, kandidatëve, anëtarëve, etj, çka ngarkon me përgjegjësi drejtuesin në nivel politik e menaxherial të partisë politike, në strukturat përkatëse, në degë apo në qendër.

Lidhur me këtë, për të rritur sensibilitetin politik e menaxherial të partisë politike dhe strukturave të saj, rekomandohet që të citohet shprehimisht në ligj parashikimi i procedurave të nevojshme nga vetë partia politike, të cilat të çojnë përgjegjësitë respektive tek individët funksionarë të partisë, të ngarkuar me mbikqyrje dhe sigurim të zbatimit të ligjit në çdo nivel të strukturës së partisë në raport me financat.

Po ashtu, rekomandohet që të specifikohet në ligj detyrimi që çdo parti politike të deklarojë në KQZ, në fillim të çdo viti vendosjen në funksionim të regjistrit të të ardhurave financiare dhe materiale, si element minimal i transparencës dhe kontrollit të përcaktuar në nenin 9 pika 1.

Po ashtu, të deklarojë strukturën menaxheriale në raport me financat, adresën dhe kontaktet përditësuar të partisë politike, drejtuesit/drejtuesve të partisë dhe të financierit të partisë.

Neni 17 – Kontrolli financiar

II.27. Detyrimi eksplicit që të gjitha partitë të auditohen

Neni 17 duhet të qartësojë se detyrimi për auditim dhe kontroll nuk lidhet vetëm me rastet kur partia politike ka dorëzuar raportin financiar, sepse përndryshe mosdorëzimi i raportit do të prodhonte efektin absurd që subjekti sanksionohet vetëm për mosdorëzim, por mbetet jashtë kontrollit për shkelje të tjera eventuale dhe aktivitet financiar që mund të ketë kryer.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Po ashtu, **afatet e parashikuara për caktimin e audituesve duhet të rishikohen** pasi duken jo realiste në praktikë.

Nevojitet të merret në konsideratë mundësia e dorëzimit të raporteve të paplotë dhe jashtë formatit prej partive politike, sikurse ndodh në vijimësi.

Në këto raste, struktura përgjegjëse në KQZ mundet dhe duhet të kthejë raportin vjetor partisë politike përkatëse për plotësime ose korrigjime të nevojshme brenda një afati të shkurtër kohor, pas fillimit të shqyritimit të tyre pas datës 1 prill.

Ky veprim konsiderohet i arsyeshëm për shkak të praktikës së ndjekur deri më sot, mungesës së informimit të duhur të partive politike, si dhe për të mos ekspozuar direkt e bërë faktike menjëherë situatën me shkelje përballë KQZ-së e audituesve, shkelje të cilat implikojnë më pas marrjen e detyrueshme të sanksioneve të parashikuara ligjore.

II.28. Pika 4 – Akresi i audituesit dhe natyra e opinionit të tij

Dispozita duhet të ri-shkruhet duke i dhënë autoritet të plotë audituesit ligjor në ushtrimin e detyrës së tij përgjatë procesit të auditimit të veprimtarisë financiare vjetore të partisë politike. Kjo në linjë edhe me qasjen e gjithë pranuar ku konsiderohet Audituesi Ligjor i vetmi autoritet i cili mund të kryejë auditim të plotë duke bërë trasnparencën e duhur, verifikimet e nevojshme, si dhe kontrollin tërësor mbi tërë aktivitetin financiar vjetor të partisë politike.

Dispozita duhet të **qartësojë shprehimisht se audituesit ligjor i sigurohet akses në të gjithë regjistrat dhe dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet nga ligji dhe standardet e auditimit për të verifikuar zbatimin dhe respektimin e tyre nga partia politike.**

Po ashtu, nevojitet të **përcaktohet shprehimisht se audituesi ligjor jep opinionin e tij të plotë e të detajuar mbi bazën e verifikimeve të nevojshme të kryera dhe jo thjesht dhe vetëm mbi dokumentacionin e dorëzuar formalisht nga subjekti që auditohet.**

Njsë qasje e tillë pritet të rrisë e përmirësojë mekanizmin e kontrollit efektiv të financimeve politike dhe të auditimit e mbikëqyrjes.

Neni 18 – Publikimi i të dhënave

II.29. Shtrirja e kufizuar e detyrimit të vetëpublikimit

Projektligji ndërton dy shtresa transparence: neni 13, pika 5 detyron KQZ-në të publikojë raportet e të gjitha partive brenda 30 ditëve nga dorëzimi; neni 18 shton mbi partitë parlamentare detyrimin e vetëpublikimit aktiv në faqen e tyre të internetit.

Partitë joparlamentare, edhe kur përfitojnë fonde publike, nuk e kanë këtë detyrim të dytë, duke krijuar dy regjime transparence të pabarabarta.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Rekomandohet që **detyrimi i vetëpublikimit të shtrihet të paktën te të gjitha partitë që përfitojnë fonde publike; përmbajtja e publikimit të zgjerohet duke përfshirë të dhëna të plota dhe të strukturuar mbi të ardhurat, shpenzimet dhe dhuruesit; si dhe detyrimi i vetëpublikimit të ruhet si detyrim autonom paralel me publikimin e KQZ-së.**

Për më tepër, KRIIK vlerëson se publikimi nuk duhet të kufizohet vetëm në baza vjetore. **Partitë politike që përfitojnë fonde publike duhet të kenë detyrimin të publikojnë në mënyrë periodike (p.sh. së paku çdo katër muaj) regjistrin e shpenzimeve dhe të blerjeve të kryera, në mënyrë që transparenca të jetë reale dhe jo vetëm retrospektive.**

Në rast se partia nuk e përmbush këtë detyrim, duhet të konsiderohet mundësia që **KQZ-ja, mbi bazën e informacionit lehtësisht të disponueshëm nga administrata tatimore dhe burime të tjera zyrtare (të dhënat mbi aktivitetin financiar mbi bazën e NIPT-it të partisë përkatëse politike), të publikojë të dhënat që ajo administron, pa cënuar përgjegjësinë parësore të partisë politike.**

Për këtë nevojitet që shprehimisht në ligj të parashikohet **detyrimi i administratës tatimore për të nxjerrë çdo katër muaj tërë aktivitetin financiar të partive politike**, si dhe të grupuara sipas grup-zërave të veçantë. Këta të fundit dhe formatin mbi të cilën mund të grupohen të dhënat e marra nga administrata tatimore, **duhet të miratohen me akt të posaçëm nga KQZ-ja duke siguruar një informacion sa më të plotë periodik**, i cili të mund të bëjë sa më shumë transparencë dhe minimizojë nga ana tjetër mundësitë për anashkalim apo pasqyrim të të dhënave jo të vërteta.

Lidhur me këtë propozim, KRIIK ju sjell në vëmendje se edhe në **Relacionin** e këtij projekt-ligji, konkretisht në Kreun III “Vlerësimi i ligjshmërisë, kushtetutshmërisë dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi vendas e ndërkombëtar” në pikën 5. “Rekomandimet e OSBE/ODIHR-it” **deklarohet shprehimisht** se “... Projektligji përmbush të gjitha këto kritere përmes rrisë së transparencës elektronike në kohë reale (neni 24) si dhe **detyrimi për publikim tremujor të shpenzimeve dhe donacioneve (neni 18)** pasqyrojnë drejtpërdrejt rekomandimet e OSBE/ODIHR-it për rritjen e kontrollit publik dhe publikimin periodik të të dhënave financiare, të theksuara prej tyre në raportet e fundit për Shqipërinë.”, ndërkohë që ky parashikim nuk pasqyrohet në projekt-ligj.

KRIIK **nxit Komisionin ta trupëzojë këtë transparencë të rritur duke e shtuar dhe bërë pjesë të dispozitës ligjore, së paku në periodicitetin katërmujor**, pra të bëhet publikimi i të dhënave informuese përmbledhëse dhe domethënëse, sikurse është cituar më lart, çdo katër muaj nga vetë partia politike dhe vetë KQZ-ja bazuar në të dhënat e organeve tatimore.

Po ashtu, nuk kuptohet arsyeja e reduktimit të afatit të publikimit në faqen e internetit vetëm për 3 vite, sikurse parashikohet në gjurmën “c) të mbajë të publikuar së paku tre vite rresht në faqen zyrtare të saj në internet raportin financiar vjetor”.

Rekomandohet që, nëse ekzistojnë arsye të qenësishme për të mbajtur të publikuar raportin vjetor financiar vetëm për një periudhë të kufizuar kohe, atëherë **kjo periudhë detyrimi për publikim të shtrihet së paku në 5 vite**. Kjo periudhë do të ndihmonte dhe ofronte një informacion më të plotë mbi çdo aktor dhe sidomos ndaj qytetarëve-votues për të kuptuar veprimtarinë financiare dhe marrëdhënien me ligjzbatimin të çdo partie në periudhën 5-vjeçare të mëparshme, përpara datës së votimit.

Gjithashtu, **mbajtja e publikuar për një periudhë sa më të gjatë krijon mundësi më të mëdha për informim përmbajtësor të publikut**, kryerjen e krahasimeve apo kryqëzimeve të të dhënave, për qasje studimore, investiguese, etj, duke rritur akoma më shumë transparencën dhe mundësitë për kontroll e denoncime nga publiku, si dhe, nga ana tjetër, forcimin e klimës së zbatimit të ligjit edhe prej vetë partive politike duke ndikuar gjithashtu edhe në rritjen e besimit të qytetarëve.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Neni 19 – Organi përgjegjës për financimin e partive politike

II.30. Pika 1 – Verifikimi i aktivitetit të plotë financiar vjetor dhe kryqëzimi i raporteve

Konsiderohet tejet e domosdoshme që të përcaktohet shprehimisht se **KQZ-ja verifikon dhe kryqëzon raportin financiar vjetor të partisë me raportin e financimit të fushatës zgjedhore, në rastin e vitit zgjedhor.**

Në formatin e detajuar vjetor të raportimit duhet të përfshihet i gjithë aktiviteti vjetor financiar i partisë politike, përfshirë këtu edhe zërat që lidhen me fushatën zgjedhore, në rastin e vitit zgjedhor. Lidhur me këta të fundit, në formatin e Raportit Vjetor mund të shtohet një kolonë e posaçme, ku të shënohet se këto zëra janë pjesë e raportit financiar të fushatës zgjedhore, të cilat janë deklaruar dhe kontrolluar edhe më parë. (shih II.23. Pika 4 – Paqartësia lidhur me raportimin e fushatës zgjedhore).

Kjo përfshirje **do të mundësonte një panoramë të plotë e të qartë të të gjithë aktivitetit financiar të partisë**, pa krijuar xhepa apo blloqe të mbyllura, në të cilat mund të fshihen apo dublohen zëra financiarë, qofshin këto të ardhura apo shpenzime, e mos lejuar kështu kryerjen e kryqëzimeve dhe përjasjeve të nevojshme për të siguruar një transparencë dhe kontroll të plotë e të vërtetë, sikurse ka ndodhur deri më tani.

Këto zëra shpenzimesh të fushatës zgjedhore, si rregull, mund të mos konsiderohen për ri-verifikim gjatë procesit të verifikimit të raportit vjetor financiar të partisë prej KQZ-së apo gjatë procesit të auditimit prej Auditit Ligjor, ashtu sikurse edhe **mund të ri-verifikohen nëse konstatohet e nevojshme prej KQZ-së apo Audituesve** për procesin e plotë të verifikimit dhe auditimit lidhur me përjasjet e bëra apo indiciet e marra nga qytetarët apo aktorë të tjerë.

II.31. Pika 2 – Qartësimi i terminologjisë dhe funksionit

Vlerësohet pozitivisht forcimi i mëtejshëm i rolit të KQZ-së duke i dhënëtribute dhe rol monitorues në aktivitetin vjetor financiar të partive politike.

Në këtë kuadër, në nenin 19, pika 2, shkronja “a” **duhet të qartësohet më mirë se çfarë kuptohet me “monitorim”, “mbikëqyrje” dhe “auditim financiar”** në kuadër të financimit vjetor të partive politike, në mënyrë që të mos mbeten të përziera konceptet që i përkasin monitorimit të fushatës zgjedhore me ato që lidhen me kontrollin e veprimtarisë financiare vjetore.

Po ashtu, **rekomandohet që formatet e standardizuara të raportimit vjetor të hartohen në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe administratën tatimore**, si për të garantuar koherencën e formatit, ashtu edhe për të mundësuar kontroll të kryqëzuar më efektiv më pas, në bashkëpunim edhe me institucione të tjera monitoruese financiare. Ndaj është e nevojshme që ligji të saktësojë shprehimisht që KQZ-ja në hartimin e formateve të **ndërveprojë me institucionet e tjera** monitoruese financiare.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

II.32. Pika 3 – Qartësimi i detyrave të strukturës përgjegjëse

Vlerësohet pozitivisht përcaktimi në ligj i një strukture të posaçme përgjegjëse për financimin, monitorimin dhe kontrollin e financimit të partive politike.

Rekomandohet se është i nevojshëm jo vetëm parashikimi i ekzistencës së kësaj strukture përgjegjëse brenda KQZ-së, por edhe **përcaktimi në ligj dhe qartësimi i mëtejshëm i detyrave dhe funksioneve të saj**, në raport me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, verifikimin formal dhe material, kontrollin e kryqëzuar, bashkëpunimin ndër-institucional, publikimin, përgatitjen e gjetjeve, iniciimin e procedurave administrative, etj..

Gjithashtu, konsiderohet e nevojshme që të **përcaktohen afate të qarta në ligj për përfundimin e procesit të kontrollit dhe verifikimit nga KQZ-ja.**

Neni 20 – Masat lehtësuese

II.33. Përdorimi i hapësirës në radiotelevizionin publik gjatë gjithë vitit

Vlerësohet pozitivisht detyrimi me ligj i **përdorimit pa shpërblim prej partive politike të mjeteve të informimit masiv publik**, të cilat konsiderohen mjete/kanale informimi të publikut të gjerë që zotërojnë dhe përdorin një të mirë publike dhe me akses të gjerë e të garantuar tek publiku. Ndaj konsiderohet me vend që ky parashikim ligjor i cili është në dobi të një të mire publike madhore, sikurse është sigurimi i pluralizimit dhe informimit të lirë të publikut të gjerë nga partitë politike për çështje zgjedhore e referendare.

Në funksion të këtij parashikimi është i nevojshëm **përcaktimi i qartë i kuptimit të drejtë të tij në nenin 2 “Përkufizime” të këtij ligji**, sikurse edhe adresimi në një moment të mëvonshëm i këtij parashikimi edhe në amendimet që duhet t’i bëhen **Kodit Zgjedhor** prej Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

Rekomandohet të konsiderohet mundësia e shtimit të së drejtës së përdorimit pa pagesë në mjetet e informimit masiv publik, edhe gjatë vitit dhe jo vetëm gjatë fushatave zgjedhore apo referendare, për çështje me interes publik të gjykuara nga partitë politike, sipas kriterëve të barazisë dhe pluralizmit.

Në këtë kuadër **propozohet që kjo e drejtë tu jepet të gjitha partive të cilat marrin fonde publike**. Koha në dispozicion për çdo parti dhe përdorimi i saj përgjatë vitit të rregullohet me një akt të përbashkët të KQZ-së dhe AMA-s.

Gjykohet se kjo e drejtë, përpos se nxit e forcon pluralizmin në vend, është në linjë me rekomandimet ndërkombëtare për uljen e kostove të aktivitetit politik e ndërtimit të një marrëdhënie korrekte, të panjollësor e parimore në përmbushjen e misionëve respektive të partive politike dhe mjeteve të informimit masiv në raport me publikun.

Neni 21 – Masa administrative

II.34. Gjoha dhe vazhdimi i detyrimit të publikimit

Neni 21, pika 1.a parashikon gjobë për mosmbajtjen e regjistrimit të të ardhurave financiare dhe materiale nga partia politike sipas nenit 9 pika 1, ashtu sikurse edhe në pikën 1.e parashikohet gjobë për shkeljen e nenit 18 për publikimin e të dhënave në faqen e internetit të partisë politike.

Në të dyja rastet dispozita nuk sqaron se çfarë ndodh me detyrimin e papërmbushur ende.

A duhet të detyrohet përmbushja e normës edhe pas vendosjes së gjobës, në rastet konkrete respektivisht, fillimi i mbajtjes së regjistrimit dhe publikimi i të dhënave në faqen e internetit? Apo do të konsiderohet se çmimi i moszbatimit të detyrimit u pagua me

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

vendosjen e gjobës dhe detyrimi ligjor do të vijojë të mbetet i pazbatuar, duke zhbërë kështu mekanizmin e ndërtuar të transparencës? Rekomandohet që të parashikohet shprehimisht se **gjoba nuk e shuan përmbushjen e detyrimit të kërkuar, pra detyrimin për publikim në rastin e dytë; partia mbetet e detyruar ta publikojë edhe pas gjobës.** Për të garantuar përmbushjen e detyrimit, mund të parashikohet penalitet ditor për çdo ditë vonese, si dhe pasoja të përshkallëzuara në rast përsëritje.

II.35. Niveli i gjobave dhe efektiviteti i tyre

KRIIK vlerëson se **niveli aktual i disa prej sanksioneve administrative mbetet i pamjaftueshëm për të siguruar efekt real parandalues.** Madje në rastin e partive politike më të mëdha të cilat administrojnë të ardhura shumëmilionëshe, nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera, sasia e gjobave të marra ndaj tyre është në përmasa të papërfillshme, duke mos patur asnjë efekt parandalues në përsëritjen e shkeljeve, të cilat vijnë nga viti në vit.

Kjo situatë e bën të pakuptimtë tërë mekanizmin rregullator e parandalues duke e zhbërë atë, dhe duke nxitur madje edhe një qëndrim refraktar e pasiv të vetë KQZ-së, pasi lloji i shkeljeve dhe mangësive vijon të jetë i madh në numër dhe i gjerë në shtrirje.

Për këtë arsye, **rekomandohet marrja në konsideratë e rritjes së gjobave në rastet më serioze të shkeljeve, si dhe parashikimi i sanksioneve plotësuese detyruese, të lidhura me natyrën dhe përsëritjen e shkeljes.**

Rekomandohet që **sanksionet financiare të parashikojnë një marzh shume të gjobës ose një përqindje të caktuar** numri njëshifror natyror mbi shumën e aktivitetit financiar vjetor të vitit paraardhës të partisë politike, **duke aplikuar si masë sanksionuese atë shumë që është më e madhe.**

Kjo mënyrë bën të mundur aplikimin e gjobave proporcionale me sasinë e fondeve / xhirros vjetore financiare të partive politike, duke siguruar parimin e barazisë nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, mos-ridikulizimin e mëtejshëm të masave dhe normës sanksionuese.

Në mënyrë të veçantë, **për shkeljet e parashikuara në nenin 21, pika 1, shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, KRIIK rekomandon që përgjegjësia administrative të mos rëndojë vetëm mbi subjektin dhurues, por edhe mbi partinë politike përfituese.** Në këto raste, partia politike duhet të mbajë përgjegjësi e të dënohet gjithashtu me gjobë, së paku në vlerën e dhurimit të marrë në kundërshtim me ligjin.

II.36. Përgjegjësia jo vetëm e financierit

Neni 12 parashikon se personi përgjegjës për financat është personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e të gjitha veprimeve me karakter financiar të partisë politike, që mban përgjegjësi dhe që përfaqëson partinë politike për financimin në raport me KQZ-në.

Shkeljet e evidentuara në vite nuk janë thjesht shkelje dhe pasaktësi që lidhen me punën specifike të financierit, pasi një pjesë e tyre lidhen në mënyrë të drejtpërdrejt me mospërgjegjësi ndaj drejtimit menaxherial dhe politik të partisë prej organeve të saj, degëve, kandidatëve, anëtarëve, etj, çka ngarkon me përgjegjësi drejtuesin në nivel politik e menaxherial të partisë politike, në strukturat përkatëse, në degë apo në qendër.

Lidhur me këtë, për të rritur sensibilitetin politik e menaxherial të partisë politike dhe strukturave të saj, **rekomandohet që të parashikohen procedura të nevojshme të cilat**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

të çojnë përgjegjësitë respektive tek individë funksionarë të partisë, të ngarkuar me mbikqyrje dhe sigurim të zbatimit të ligjit në çdo nivel të strukturës së partisë në raport me financat. Kjo në vijim edhe të parashikimeve të bëra në nenin 15 të projekt-ligjit.

Për sa më sipër, **rekomandohet që sanksionet të parashikojnë gjoba plotësuese të cilat iu adresohen personave përgjegjës konkretë të strukturave drejtuese partiake**, përpos se ndaj financierit të partisë, sikurse parashihet në gërmën “g” të nenit 21 të projekt-ligjit.

Në mungesë, të identifikimit të këtyre personave, **gjoba të aplikohet ndaj drejtuesit të degës me të cilën lidhet shkelja ose me drejtuesin e vetë partisë politike**, nëse nuk ka struktura të tjera hierarkike të drejtimit dhe mbajtjes së përgjegjësisë.

Neni 24 - Përdorimi i teknologjisë së informacionit

II.37. Pika 2 – Detyrimi për publikimin në faqen e partisë

KRIIK vlerëson se nuk është e arsyeshme që funksionalizimi i platformës elektronike të KQZ-së të çojë në eliminimin e detyrimit të partive politike për raportim në KQZ dhe publikim në faqen e tyre të internetit. **Të dyja këto forma publikimi duhet të bashkë-ekzistojnë**, pasi i shërbejnë niveleve të ndryshme të transparencës dhe aksesit publik. Për rrjedhojë, neni 24, pika 2 duhet të riformulohet në mënyrë që **publikimi në platformën e KQZ-së të mos zëvendësojë, por të plotësojë detyrimin e vetë partisë për publikim aktiv**.

II.38. Pika 2 – Detyrimi për arshivimin në hardcopy të raporteve

Gjithashtu, funksionaliteti i platformës online, nuk duhet të zhbëjë ruajtjen në hardcopy të raporteve, me firmë e vulë, si kopje në arshivën e institucionit të KQZ-së, kopje që mund të gjenerohet nga printimi prej sistemit me vulë dixhitale në formatet .pdf apo excel.

Rëndësia dhe ndjeshmëria ndaj përmbytjes së raporteve të detajuara të aktivitetit financiar të partive politike, paraqesin **domosdoshmërinë e ruajtjes së kopjeve të printuara në letër në arshivën e KQZ-së**, pavarësisht sigurisë dhe disponibilitetit që mund të ofrojë në dukje apo në realitet platforma elektronike e KQZ-së.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

Me konsideratë,

***Për* Koalicionin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

Premto GOGO

Kryetar

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania